

There are no translations available.



Në datën 16 nëntor 2012, Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Tipografisë, në kuadrin e 100 Vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, organizoi një konferencë kombëtare, që kishte si qëllim të saj të promovonte rolin dhe kontributin e tipografëve në këto 100 vjet Shqipëri e pavarur dhe shtet shqiptar.

Në këtë veprimtari morën pjesë sindikalistë tipografë, drejtues të ndërmarrjeve të industrisë tipografike, si partnerët tanë socialë nga shtypshkronjat më të mëdha të vendit si Shtypshkronja "Ilar", Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, Shtypshkronja "Kristalina", "Mihal Duri i Ri", "Milenium", etj, miq e drejtues të sindikatave të tjera që bashkëveprojmë e bëjnë pjesë në

familjen e madhe të BSPSH-së, si dhe të ftuar nga organizatat e shoqërisë civile me të cilat kemi bashkëpunuar gjatë këtyre viteve.

Nëpërmjet dy kumtesave, që u referuan në këtë konferencë, u soll në vëmendjen e pjesëmarrësve një historik i shkurtër i kontributit të tipografëve në krijimin e shtetit shqiptar, si dhe roli i Sindikatës së Pavarur të Punonjësve të Tipografisë të Shqipërisë, në krijimin strukturave të sindikaliste dhe forcimin e veprimtarisë së lëvizjes saj, veçanërisht në vitet e demokracisë.

Këto punime u mbajtën nga znj. Hiqmete Daja, Presidente e Sindikatës së Pavarur të Tipografëve dhe zoti Hasan Kasmi, Zëvendëspresident i kësaj Sindikate.

Më pas për pjesëmarrësit sindikata e Pavarur e Tipografisë shtroi një darkë festive.

Këtë veprimtari e nderoi me pjesëmarrjen e tij edhe Presidenti i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, Zoti Gëzim Kalaja, i cili mbajti një fjalë përshëndetëse dhe në emër të BSPSH, i dha Sindikatës së Pavarur të Tipografisë “Certifikatën e Mirënjohjes” për kontributin e saj në krijimin e BSPSH-së dhe zhvillimet në këtë sindikatë.